



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 569/1 Prot

Tiranë, më 26/5/2016

Lënda:

*Jepet mendim mbi Projektvendimin "Për miratimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, procedurës së plotësimit dhe dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit dhe dokumenteve shoqëruese të tij, për administrimin e tyre nga autoritete përgjegjëse dhe për një shtesë buxheti Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin 2016".*

Drejtuar: Z. Saimir TAHIRI

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME

TIRANË

I nderuar Z.Tahiri,

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr.3262 Prot, datë 16.05.2016, për dhënie mendimi mbi projektvendimin "Për miratimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, procedurës së plotësimit dhe dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit dhe dokumenteve shoqëruese të tij, për administrimin e tyre nga autoritete përgjegjëse dhe për një shtesë buxheti Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme për vitin 2016", do të vlerësonim përshtatjen me sugjerimet e mëposhtme.

Në formularin tip të vetëdeklarimit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i pasqyruar në Shtojcën Nr. 1 të projektvendimit, të parashikohet informimi i subjektit të të dhënave në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Informimi duhet të parashikojë qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë teknike dhe fizike, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe të drejtat që gëzon subjekti i të dhënave personale. Gjithashtu subjektet e të dhënave (shtetasit shqiptarë) duhet të informohen edhe nëse të dhënat e tyre do të përhapen apo transferohen në kontrollues publikë ose privatë të tjerë.

Në zbatim të parashikimeve të projektvendimit, në faqen zyrtare të autoriteteve përgjegjëse në të cilën shtetasit shqiptarë do të aplikojnë për plotësimin e formularit tip të vetëdeklarimit, të shtohet një link (nënfaqe) ku të pasqyrohet politika e privatësisë në përputhje me nenin 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Në përfundim, sugjerimet e dhëna ndër të tjera kushtëzojnë përmbajtjen e formularit të vetëdeklarimit në mbledhjen e të dhënave. Kjo do të thotë që sasia e të dhënave që do të mblidhet në këtë formular nuk duhet të tejkalojë qëllimin e përcaktuar në këtë projektvendim. Sugjerojmë që në Shtojcën Nr. 1 të projektvendimit “*numri i telefonit*” si e dhënë për tu plotësuar nga aplikantët, të parashikohet te fusha e rubrikave të cilat nuk janë të detyrueshme për t’u plotësuar, pasi tejkalon qëllimin e përpunimit në kundërshtim me nenin 5/1/c të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

